Numër: 01-981 Datë: 13.10.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2026 merr:

V E N D I M

1. Riakreditohet dhe rivalidohet Qendra e Gjuhëve të Huaja EU, me adresë Rr. Emin Duraku Nr. 3, 70000 Ferizaj, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 811071076, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 07.10.2026 deri më 06.10.2031, për kualifikimin e aprovuar në Komizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

1.1 Numri maksimal i kandidatëve për grup është deri në 18 pjesëmarrës, ndërsa numri i klasave aktive është 10, me gjithsej 5 cikle ditore. Bazuar në këto kapacitete, parashihet realizimi i deri në 900 pjesëmarrësve në ditë, në të gjitha klasat dhe ciklet e organizuara. Në përputhje me kapacitetet ekzistuese, parashihet realizimi i rreth 180 deri në 200 grupeve brenda një viti, në të gjitha nivelet e gjuhës gjermane nga A1 deri në C1, me kapacitet të përgjithshëm vjetor të planifikuar prej rreth 3,200 deri në 3,600 kandidatëve/kursantëve.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Qendrës së Gjuhëve të Huaja EU, me adresë Rr. Emin Duraku Nr. 3, 70000 Ferizaj, për riakreditimin e kualifikimit "Kurse të Gjuhës Gjermane", nivelet A1–C1, si dhe rekomandimit të ekipit të ekspertëve të akreditimit, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjatë vizitës vlerësuese, ekipi i ekspertëve shqyrtoi organizimin e institucionit, infrastrukturën, pajisjet dhe materialet didaktike, kapacitetet profesionale të stafit, organizimin e procesit mësimor, si dhe kapacitetet për vlerësimin dhe certifikimin e kandidatëve. Objekti është i pajisur me kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të vlerësimit, përfshirë kompjuterë, laptopë, projektorë, printerë, skanerë, sisteme audio-vizuale, tabela interaktive dhe tabela të bardha. Gjithashtu, institucioni disponon tekste dhe materiale didaktike të përshtatshme për nivelet A1-C1, përfshirë materialet mësimore *Schritte international neu* për nivelet A1-B1 dhe *Sicher!* për nivelet B2-C1, të bazuara në Kornizën e Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (CEFR).

Ekipi i ekspertëve konstatoi se institucioni ka të angazhuar dhjetë (10) mësimdhënës të gjuhës gjermane, me kualifikime akademike dhe përvojë profesionale përkatëse. Këto kapacitete mundësojnë organizimin dhe realizimin e procesit mësimor dhe të vlerësimit për kualifikimin përkatës.

Sa i përket numrit të kandidatëve, bazuar në kapacitetet infrastrukturore dhe organizimin e procesit mësimor, ekipi i ekspertëve vlerësoi se institucioni mund të organizojë grupe me deri në tetëmbëdhjetë (18) kandidatë, me rreth dyqind (200) grupe në vit. Në bazë të këtyre të dhënave, kapaciteti maksimal i parashikuar është deri në tre mijë e gjashtëqind (3,600) kandidatë në vit, në të gjitha nivelet e gjuhës gjermane A1-C1. Dokumentacioni i paraqitur nga institucioni, përfshirë Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentet mbështetëse, ofroi informata relevante për shqyrtimin e aplikacionit dhe vlerësimin e kritereve të akreditimit. Gjithashtu, institucioni ka ofruar dokumentacionin shtesë të kërkuar nga ekipi i ekspertëve gjatë procesit të vlerësimit.

Rekomandohet institucioni që Raportin e Vetëvlerësimit ta hartojë, përditësojë dhe mirëmbajë në mënyrë të strukturuar dhe të rregullt, në përputhje me procedurat dhe kërkesat e AKK-së, duke e përdorur atë si instrument për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Për bashkëpunimet e deklaruara me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, rekomandohet sigurimi dhe paraqitja e dëshmive konkrete e të dokumentuara, përfshirë marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit, të gjeturave nga vizita vlerësuese dhe raportit të ekipit të ekspertëve, i cili rekomandoi akreditimin e institucionit, Këshilli Drejtues i AKK-së, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë për rishqyrtim të vendimit, sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet Këshillit Drejtues të AKK-së brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e lëshimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. Qendrës së Gjuhëve të Huaja EU, Ferizaj;
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve